



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TERMOHIDRAULIKË”

V-II-20

Niveli i dytë në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

Tiranë, Korrik 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Termohidraulikë			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	V-II-20
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Termohidraulikë”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë (ndihmës), për instalimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve termohidraulike në profesionet që lidhen drejtpërdrejt me fushën e termohidraulikës, si dhe të zhvillojë personalitetin e nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Termohidraulikë”, të nivelit II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Termohidraulikë”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim profesional i jep individit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar si ndihmës për punime instalimi, riparimi, mirëmbajtjeje të sistemeve termohidraulike në sipërmarrje që kryejnë veprimtari në fushën e termohidraulikës, në sipërmarrjet e ndërtimit të objekteve të ndryshme, në ndërmarrje të ujësjellës kanalizimeve, si dhe në njësitë e tregimit të pajisjeve, veglave dhe materialeve hidro-sanitare etj.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Termohidraulikë”, niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III-të në KSHK-së, referuar nivelit III të KEK, në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimimin e mëtejshëm në nivelin IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për të vazhduar studimet pas të mesme ose universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	U-II-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Hartimi i skicave dhe vizatimi teknik në termohidraulikë

- Të argumentojë rëndësinë e vizatimit teknik dhe skematik;
- Të listojë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer vizatime dhe skica;
- Të përshkruajë llojet e shkrimit teknik;
- Të përshkruajë shkallët e paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
- Të interpretojë simbolet e rakorderive dhe armaturave kryesore në vizatimet teknike dhe skematike;
- Të interpretojë shenjat konvencionale të pajisjeve hidraulike dhe atyre ngrohëse;
- Të interpretojë skica të thjeshta të instalimeve hidraulike, sistemeve të ngrohje ftohjes dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Të interpretojë vizatimet për detajet më tipike të instalimeve hidraulike, sistemeve të ngrohje –ftohjes dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Të interpretojë vizatimet e pamjeve, prerjeve, në plane të ndryshme, të objekteve;
- Të interpretojë vizatime të planimetrisë, pamjes, prerjes, etj., për një ndërtesë të thjeshtë;
- Të interpretojë paraqitjet aksonometrike të skemave të thjeshta të instalimeve hidraulike, sistemeve të ngrohje –ftohjes dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e vizatimeve me kompjuter dhe programet përkatëse;

Materialet metalike dhe jometalike që përdoren në instalimet termohidraulike

- Të klasifikojë materialet metalike dhe jo-metalike;
- Të përkufizojë vetitë fizike dhe kimike të materialeve kryesore;
- Të përshkruajë metalet e zeza dhe përdorimin e tyre në termohidraulikë;
- Të përshkruajë metalet me ngjyrë dhe përdorimin e tyre në termohidraulikë;
- Të përshkruajë lidhjet kundra fërkimit dhe përdorimin e tyre në hidraulikë;
- Të përshkruajë lidhjet e forta;
- Të listojë materialet jo-metalike që përdoren në termohidraulikë;
- Të përshkruajë materialet qeramike dhe përdorimin e tyre në hidraulikë;
- Të përshkruajë materialet plastike dhe përdorimin e tyre në termohidraulikë;
- Të klasifikojë tubat sipas materialit;
- Të përshkruajë korrozionin dhe mbrojtjen nga korrozioni;
- Të përshkruajë masat parandaluese kundër korrozionit;

Teknologjia e përpunimit të materialeve në instalimet termohidraulike

- Të përshkruajë llojet e provave teknologjike të materialeve kryesore;
- Të përshkruajë llojet e provave mekanike të materialeve kryesore;

- Të përshkruajë metodat kryesore të prodhimit të materialeve kryesore;
- Të tregojë proceset kryesore të axhusterisë;
- Të përshkruajë veçoritë e prerjes së materialeve kryesore;
- Të përshkruajë procesin e shpimit;
- Të përshkruajë bashkimet me fileta;
- Të përshkruajë llojet e fileteve që përdoren në hidraulikë;
- Të përshkruajë llojet e bashkimeve me saldim dhe pajisjet që përdoren;
- Të përshkruajë veçoritë e ngjitjes së materialeve;
- Të përshkruajë ngjitjen e bakrit, aluminit dhe lidhjeve te tyre;
- Të përshkruajë teknologjinë e ngjitjes me kallaj;
- Të përshkruajë bashkimet me kiaveta;
- Të përshkruajë bashkimet me ribatina;
- Të përshkruajë veçoritë e përpunimit plastik të tubave;
- Të përshkruajë veglat e punës së hidraulikut;
- Të përshkruajë metodat e bashkimit të tubave metalikë dhe jometalikë;
- Të përshkruajë llojet e matjeve dhe tolerancave;
- Të përshkruajë karakteristikat e sistemit të tolerancave;

Materialet e ndërtimit dhe elementet e një banese

- Të klasifikojë materialet që përdoren në ndërtim;
- Të përshkruajë vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit;
- Të përshkruajë karakteristikat e materialeve mbushës (rërës, granilit, çakëllit);
- Të përshkruajë karakteristikat e materialeve lidhës (allçisë, gëlqeres, çimentos);
- Të përshkruajë karakteristikat e materialeve të tjera në ndërtim (hidro-izoluese, termo-izoluese, qeramikë etj.);
- Të përshkruajë karakteristikat e materialeve të parapërgatitura prej betonarmeje;
- Të përshkruajë llojet e llaçit dhe përgatitjen e tyre;
- Të përshkruajë procesin e përgatitjes së llaçit dhe betonit;
- Të përshkruajë llojet e tullave që përdoren në ndërtim;
- Të klasifikojë ndërtesat sipas funksionit të tyre;
- Të përshkruajë elementet kryesore të ndërtesave;
- Të përshkruajë ndërtimin e ndërtesave me skelet betonarmeje;
- Të përshkruajë ndërtimin e ndërtesave me gur;
- Të përshkruajë ndërtimin e ndërtesave me tulla;
- Të përshkruajë rregullat e ndërtimit të mureve mbajtës dhe ndarës;
- Të interpretojë një planimetri të një godine banimi;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit në ndërtim;

Hidraulika e zbatuar

- Të përshkruajë lëngjet dhe vetitë e lëngjeve;
- Të përshkruajë presionin hidrostatik dhe vetitë e tij;
- Të përshkruajë presionin e plotë maometrik dhe vakumetrik
- Të përshkruajë ligjet e hidrostatikës dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë zbatimin e ligjit të Paskalit në hidraulikë;
- Të përshkruajë zbatimin e ligjit të Arkimedit në hidraulikë;

- Të listojë aparatet e matjes së trysnisë në hidraulikë;
- Të përshkruajë elementet hidraulike të rrjedhjes së lëngjeve;
- Të përshkruajë llojet e lëvizjes së lëngjeve;
- Të përshkruajë ekuacionin e Bernulit;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes së shpejtësisë dhe prurjes;
- Të përshkruajë regjimet e lëvizjes së lëngjeve;
- Të përshkruajë humbjet hidraulike dhe shkaqet e lindjes së tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së thjeshtë të tubacioneve;
- Të përshkruajë goditjen hidraulike dhe mënyrat për mënjanimin e saj;
- Të përshkruajë rrjedhjen e lëngjeve nëpër vrima, hundëza dhe tubacione;
- Të përshkruajë elementet hidraulike në veprat hidroteknike;
- Të përshkruajë funksionin dhe tipet e pompave hidraulike;

Instalimet elektrike

- Të dallojë elementet dhe parametrat e qarkut të thjeshtë elektrik;
- Të përshkruajë efektet e rrymës elektrike;
- Të përshkruajë rreziqet nga elektriciteti;
- Të përshkruajë mbrojtjen nëpërmjet tokëzimit dhe nulifikimit;
- Të përshkruajë elementet e rrjetit të brendshëm elektrik të ndërtesave;
- Të përshkruajë elementet mbrojtës dhe komandues në rrjetin elektrik të ndërtesave;
- Të interpretojë simbolet dhe skemat e thjeshta elektrike;
- Të përshkruajë materialet elektro-izoluese;

Rregulla të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë veshjet dhe pajisjet mbrojtëse në punë;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të sigurt të veglave dhe mjeteve të ndryshme të punës (matëse, prerëse, shtrënguese, goditëse etj.);
- Të përshkruajë rregullat për përdorimin e makinerive në punë (trapano, sharrë bangoje etj.);
- Të përshkruajë sinjalistikën (shenjat) paralajmëruese të rreziqeve në punë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve të axhusterisë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve të saldimit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve me materialet kryesore dhe sipas proceseve të ndryshme;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë gjatë instalimit të sistemeve termohidraulike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë gjatë montimit të pajisjeve hidrosanitare;
- Të përshkruajë rregullat për lëvizjen e sigurt në një kantier ndërtimi;
- Të përshkruajë pajisjet për mbrojtjen kundra zjarrit;
- Të përshkruajë radhën e veprimeve në rast zjarri;
- Të përshkruajë radhën e veprimeve të dhënies së ndihmës së parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të përshkruajë rregullat për kujdesin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat për mirëmbajtjen dhe pastrimin e vendit të punës;
- Të përshkruajë rregullat për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve prej vendit të punës;

TEKNIKA E HIDRAULIKËS NË SISTEME TË BRENDSHME

a) Furnizimi me ujë

- Të përshkruajë përdorimin dhe rëndësinë e ujit në jetën e njerëzve;
- Të tregojë llojet e tubave në instalimet hidraulike;
- Të tregojë llojet e rakorderive në instalimet hidraulike;
- Të tregojë armaturat në instalimet hidraulike;
- Të përshkruajë pajisjet për marrjen e ujit;
- Të përshkruajë kuotat e montimit të rrjetit të furnizimit me ujë të pajisjeve hidro-sanitare, sipas standardeve;
- Të tregojë skemat e shpërndarjes të furnizimit me ujë brenda në godinë;
- Të tregojë elementët kryesorë përbërës të skemave të furnizimit me ujë;
- Të përshkruajë skemat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.
- Të përshkruajë mënyrat e përfutimit të ujit të ngrohtë në sistemet sanitare;
- Të tregojë mënyrën e realizimit të provës hidraulike;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e leximit të dokumentit teknik shoqërues të pajisjeve;
- Të listojë materialet në bazë të skicave;

b) Shkarkimi i ujërave të përdorura

- Të përshkruajë ujërat e përdorura, ujërat e zeza dhe ujërat e bardha në një godinë;
- Të tregojë elementët përbërës të rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të përshkruajë funksionet e çdo elementi të rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të përshkruajë tubat dhe rakorderitë në rrjetin e brendshëm të shkarkimit;
- Të interpretojë skica të thjeshta të rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të përshkruajë kuotat e montimit të rrjetit të shkarkimit të pajisjeve hidro-sanitare, sipas standardeve;
- Të tregojë radhën punës për shtrimin e tubave të rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të interpretojë skemat e thjeshta aksonometrike të rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të tregojë funksionin e sistemit të ajrimit të rrjetit të brendshëm të kanalizimeve;
- Të tregojë provat teknike të rrjetit të shkarkimit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik shoqërues;

c) Pajisjet hidro-sanitare

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve hidro-sanitare;
- Të përshkruajë standardet dhe rregullat për vendosjen e pajisjeve hidro-sanitare;
- Të përshkruajë aksesoret në një nyje sanitare dhe mënyrën e montimit të tyre;
- Të përshkruajë radhën e punës për montimin e pajisjeve hidro-sanitare;

TEKNIKA E HIDRAULIKËS NË SISTEME TË JASHTME

a) Sistemi i jashtëm i kanalizimit

- Të përshkruajë funksionin e rrjetit të kanalizimeve;
- Të përshkruajë skemat kryesore të kanalizimit;
- Të listojë elementet skemave të kanalizimit;
- Të përshkruajë funksionin e pusetave të kontrollit;
- Të tregojë veçoritë e kanalizimit të ujërave atmosferike;

- Të tregojë radhën e punës për shtrimin e tubave të kanalizimit;
- Të interpretojë një skemë të thjeshtë kanalizimi;
- Të tregojë përdorimet e ujërave të shiut;

b) Sistemi i jashtëm i ujësjellësit

- Të përshkruajë sistemet e furnizimit me ujë në rrjetin e jashtëm;
- Të listojë elementët kryesorë të sistemeve të furnizimit me ujë në rrjetin e jashtëm;
- Të përshkruajë burimet e furnizimit me ujë dhe veprat e marrjes;
- Të tregojë karakteristikat e ujit të pijshëm dhe analizat kryesore që i bëhen atij;
- Të klasifikojë linjat e jashtme të ujësjellësit;
- Të përkuftizojë rrjetin e jashtëm të ujësjellësit;
- Të dallojë rrjetin e hapur nga rrjeti i mbyllur i ujësjellësit;

Defektet në sistemet termohidraulike dhe riparimi i tyre

- Të përshkruajë defektet kryesore në linjat e furnizimit me ujë hidro-sanitare dhe mënyrën e riparimit të tyre;
- Të përshkruajë defektet kryesore të rrjetit të brendshëm të shkarkimit dhe mënyrat e riparimit të tyre;
- Të përshkruajë defektet kryesore në ujësjellës dhe mënyrën e riparimit të tyre;
- Të përshkruajë defektet kryesore të rrjetit të kanalizimit dhe mënyrat e riparimit të tyre;
- Të përshkruajë shkaqet e lindjes së zhurmave në sistemet e brendshme të furnizimit me ujë dhe të shkarkimit dhe mënyrat e menjanimin të tyre;
- Të përshkruajë defektet kryesore në sistemet të ngrohjes dhe mënyrën e riparimit të tyre;

Ligjet e termodinamikës

- Të përshkruajë konceptin e nxehtësisë;
- Të përshkruajë ligjet kryesore të termodinamikës;
- Të tregojë mënyrat e transmetimit të nxehtësisë
- Të përshkruajë faktorët kryesorë të komfortit termik;
- Të përshkruajë zbatimin e ligjeve të termodinamikës në praktikë;

Sistemet e ngrohjes në një ndërtesë

- Të tregojë shkaqet e humbjeve të nxehtësisë në një ndërtesë;
- Të tregojë llojet kryesore të sistemeve të ngrohjes;
- Të listojë materialet e nevojshme, sipas skemave të dhëna;
- Të listojë tubat që përdoren në sistemet e ngrohjes;
- Të dallojë armaturat që përdoren në sistemin e ngrohjes;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një skeme të një sistemi të thjeshtë ngrohjeje;
- Të përshkruajë montimin e kolektorëve në një sistem të ngrohjes;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të armaturave në sistemin e ngrohjes;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit të pompave qarkulluese, enës së zgjerimit, valvolave të ç' ajrimit;
- Të përshkruajë pajisjet e prodhimit të nxehtësisë;
- Të klasifikojë llojet e lendeve djegëse dhe mënyrën e depozitimit të tyre;

- Të tregojë llojet e trupave ngrohës, pozicionimin dhe mënyrën e lidhjes së tyre në sistemin e ngrohjes;
- Të tregojë mënyrat e shtrimit të tubave në sistemin e ngrohjes me rrezatim nga dyshemeja;
- Të përshkruajë mënyrat e termoizolimit në instalimet e sistemeve ngrohëse;
- Të përshkruajë termorregullimin;
- Të listojë dokumentacionin teknik të profesionit;
- Të tregojë mënyrën e realizimit të provës në sistemet e ngrohjes dhe regjistrimin e rezultateve të testimit;

SHPREHI PROFESIONALE

Hartim i skicave dhe vizatimi teknik në termohidraulikë

- Të lexojë dhe interpretojë skica, vizatime dhe dokumentacion teknik të termohidraulikës;
- Të kryejë vizatime të thjeshta me dorë të lirë dhe përdorë shkrimin teknik;
- Të vizatojë detaje të ndryshme duke vendosur përmasat, përdorur shkallët e vizatimit;
- Të përdorë materialet dhe veglat e vizatimit për të përgatitur skica dhe vizatime teknike të thjeshta mekanike dhe të vështirësisë mesatare, si dhe ndërtime të ndryshme gjeometrike;
- Të ndërtojë paraqitje aksonometrike të skicave të instalimeve hidraulike, sistemeve të ngrohjes dhe ujësjellës kanalizime
- Të paraqesë në skica dhe vizatime bashkime me fileto, me kiaveta, me kunjat, me perçina dhe me saldim;
- Të kryejë skica të thjeshta të instalimeve hidraulike, sistemeve të ngrohje –ftohjes dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Të zbatojë tolerancat dhe standardet në skemat e instaluar hidraulike, në sisteme të ngrohje –ftohjes dhe ujësjellës-kanalizimeve;
- Të vizatojë planimetri, pamje, prerje, për një ndërtesë të thjeshtë;

Materialet metalike dhe jometalike që përdoren në instalimet termohidraulike

- Të dallojë materialet metalike dhe jo-metalike;
- Të dallojë metalet e zeza;
- Të dallojë metalet me ngjyrë;
- Të dallojë lidhjet kryesore metalike;
- Të dallojë materialet plastike PP, PE, PVC, etj.;
- Të dallojë llojet e ngjitësve;
- Të dallojë materialet temoizoluese;
- Të dallojë llojet e tubave që përdoren në sisteme të ndryshme termohidraulike;

Materialet e ndërtimit dhe elementet e një banese

- Të përzgjedhë llojet e materialeve mbushëse;
- Të dallojë llojet e materialeve lidhëse;
- Të dallojë llojet e tullave;
- Të dallojë llojet e elementeve kryesore të ndërtesave;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

Instalimet elektrike

- Të lexojë skema të thjeshta elektrike;
- Të dallojë llojet e elementeve komanduese dhe mbrojtëse të rrjetit elektrik të ndërtesave;
- Të verifikojë skema të thjeshta të lidhjes elektrike para montimit të bolierit;

Rregulla të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përdorë veshjet dhe pajisjet mbrojtëse në punë;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të sigurtë të veglave dhe mjeteve të ndryshme të punës (matëse, prerëse, shtrënguese, goditëse etj.);
- Të zbatojë rregullat për përdorimin e makinerive në punë (trapano, sharrë bangoje etj.) ;
- Të zbatojë sinjalistikën (shenjat) paralajmëruese të rreziqeve në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve të axhusterisë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve të saldimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë gjatë punimeve me materialet kryesore dhe sipas proceseve të ndryshme;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë gjatë instalimit të sistemeve termohidraulike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë gjatë montimit të pajisjeve hidrosanitare;
- Të zbatojë rregullat për lëvizjen e sigurt në një kantier ndërtimi;
- Të zbatojë rregullat për përdorimin e pajisjeve për mbrojtjen kundra zjarrit;
- Të zbatojë radhën e veprimeve në rast zjarri;
- Të zbatojë radhën e veprimeve të dhënies së ndihmës së parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të zbatojë rregullat për kujdesin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Të zbatojë rregullat për mirëmbajtjen dhe pastrimin e vendit të punës;
- Të zbatojë rregullat për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve prej vendit të punës;

TEKNIKA E HIDRAULIKËS NË SISTEME TË BRENDSHME

a. Furnizimi me ujë

- Të përzgjedhë tubat, rakorderitë dhe armaturat në instalimet hidraulike sipas skemës;
- Të përdorë veglat e punës sipas proceseve të punës;
- Të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e veglave e punës;
- Të kryejë punime filetimi të tubit xingato me matravidë dore dhe elektrike;
- Të kryejë punime të vendosjes së materialit të dendësimi dhe lidhës;
- Të kryejë punime prerjeje me vegla dore të tubave (sharrë hekuri, taliatub dhe gërshërë);
- Të kryejë punime bashkimi me tub shumë shtresor me presim dhe shtrëngim;
- Të kryejë punime lakimi të tubave shumë shtresorë;
- Të kryejë punime prerjeje me tronkëz të tubave PP;
- Të kryejë punime të saldimit dhe ngjitjes së tubave PP;
- Të zbatojë metodat e përpunimit të tubave metalikë dhe jo-metalikë;
- Të kryejë punimet për instalimin e kolektorit shpërndarës në një apartament;
- Të kryejë punimet për instalimin e sistemit të ujit të ngrohtë me boljerë elektrikë;
- Të përzgjedhë materialet e punës në bazë të skicave të thjeshta;
- Të realizojë provën hidraulike dhe regjistrimin e rezultateve të testimit;

- Të identifikojë defektet në skemën e realizuar dhe të kryejë riparimin e tyre;
- Të lexojë dokumentin teknik shoqërues të materialeve që përdor;

b. Shkarkimi i ujërave

- Të dallojë elementet e rrjetit të brendshëm të shkarkimit;
- Të përzgjedhë tubat dhe rakorderitë për linjat e shkarkimit;
- Të zbatojë metodat e bashkimit të tubave të shkarkimit;
- Të zbatojë metodat e përpunimit të tubave të shkarkimit;
- Të zbatojë standardet e montimit të linjave të shkarkimit;
- Të zbatojë skica të thjeshta të linjave të shkarkimit;
- Të hartojë listën e materialeve për realizimin e skemës në linjat e shkarkimit;
- Të përzgjedhë materialet për realizimin e skemës në linjat e shkarkimit;
- Të kryejë provën hidraulike;
- Të identifikojë defektet dhe të kryejë riparimin e tyre;
- Të lexojë dokumentacionin teknik të profesionit;
- Të dallojë elementet e skemave të grumbullimit të ujërave të shiut;
- Të dallojë elementet e rrjetit ose impjanteve të shkarkimit;
- Të zbatojë kriteret e dimensionimit të shkarkimit të ujërave të përdorura;

c. Pajisjet hidrosanitare

- Të montojë pajisjet hidro-sanitare sipas skemës;
- Të zbatojë standardet e furnizimit dhe shkarkimit të linjave dhe pajisjeve hidro-sanitare;
- Të zbatojë standardet e vendosjes së pajisjeve hidro-sanitare në një nyje hidrosanitare;
- Të zbatojë radhën e punës për montimin e pajisjeve hidro-sanitare;
- Të montojë aksesorët në një nyje sanitare;

d. Punime të tjera

- Të kryejë matje me vegla matëse të ndryshme;
- Të kryejë punime saldimi në materialet kryesore që përdoren në termohidraulikë;
- Të kryejë punime axhustimi në materialet kryesore që përdoren në termohidraulikë;
- Të kryejë punime të ngjitjes në materialet kryesore që përdoren në hidraulikë;
- Të përgatisë llaç (allçie, gëlqere, çimento) për fiksimin e linjave;
- Të kryejë shënjimin e gjurmës së instalimeve hidraulike në një godine banimi;
- Të kryejë punime me çekiç e daltë për hapjen e kanaleve, vrimave dhe foleve;
- Të kryejë punime me matrapik e trapan;
- Të kryejë punime për nxjerrje kuotash me zorrë uji dhe aparat lazer;
- Të zbatojë mënyrat e fiksimit të tubave në mur dhe dysheme;
- Të kryejë punime pastrimi dhe rregullimi të vendit të punës;

Sistemet e ngrohjes

- Të zbatojë skica të thjeshta të sistemeve të ngrohjes;
- Të përzgjedhë tubat, armaturat dhe pajisjet në sistemin e ngrohjes;
- Të zbatojë mënyrat e bashkimit të tubave në një sistem të ngrohjes;
- Të kryejë punime përgatitore për instalimin e pompës qarkulluese, enës së zgjerimit,

valvolave të ç' ajrimit, sigurisë etj.;

- Të kryejë punime përgatitore për instalimin aparateve të këmbimit të nxehtësisë;
- Të zbatojë radhën e punës për montimin e trupave ngrohës;
- Të përzgjedhë sistemin e shpërndarjes së ujit;
- Të lexojë dokumentacionin teknik të profesionit;
- Të kryejë mbushjen dhe e sistemit të ngrohjes me ujë;
- Të kryejë provën hidraulike dhe provën termike të sistemit të ngrohjes;
- Të identifikojë defekte të thjeshta në linjat sistemit të ngrohjes dhe mënyrën e riparimit të tyre;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë instalimit të sistemit të ngrohjes;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë arritjet e tij, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

